



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 731 Prot.

Tiranë, më 07.07.2021

**URDHËR**

Nr.47, datë 07.07.2021

**“Për verifikimin e rasteve të emërimit në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Mallakastër”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 11, pika 1 dhe nenit 14, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas informacioneve të administruara nga inspektori i ngarkuar me ndjekjen e vazhdueshme të situatës së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Mallakastër, për parregullsi në procesin e plotësimit të pozicioneve të punës që janë pjesë e sistemit të shërbimit civil, duke mos respektuar procedurën e konkurrimit, Komisioneri vlerëson se lindin dyshime të arsyeshme për parregullsi në zbatimin e ligjit për nëpunësin civil në këtë institucion.

P ë r k ë t ë a r s y e

**URDHËROJ:**

1. Nisjen e inspektimit për verifikimin e informacionit në lidhje me plotësimin e pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, në kundërshtim me ligjin në Bashkinë Mallakastër.
2. Verifikimi të kryhet në subjekt nga data **12.07.2021** deri në datën **16.07.2021**, nga grupi i inspektimit i përbërë nga Drejtori i Mbikëqyrjes Altin Shumeli dhe inspektorët Matilda Idrizaj dhe Luiseda Zhapa.
3. Relacioni i përgatitur, i shoqëruar me aktet e administruara në subjekt, duhet t’i paraqiten Komisionerit për të vijuar më tej me procesin e rregullimit të situatës.

4. Grupi do të përdori automjetin e institucionit për të realizuar transportin për në subjekt.
5. Të merren masat për njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet inspektimit, në përputhje me nenin 42, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**